



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2024 – Numri: 19

Tiranë – E martë, 30 janar 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 16, datë 23.1.2024	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 2393
Dekret i Presidentit nr. 17, datë 23.1.2024	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 2393
Dekret i Presidentit nr. 18, datë 23.1.2024	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 2393
Dekret i Presidentit nr. 19, datë 23.1.2024	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 2394
Dekret i Presidentit nr. 20, datë 23.1.2024	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 2394
Dekret i Presidentit nr. 21, datë 23.1.2024	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 2394
Dekret i Presidentit nr. 22, datë 23.1.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 2395
Dekret i Presidentit nr. 23, datë 23.1.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 2395
Dekret i Presidentit nr. 24, datë 23.1.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 2395
Dekret i Presidentit nr. 25, datë 23.1.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 2396
Dekret i Presidentit nr. 26, datë 23.1.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 2396

Dekret i Presidentit nr. 27, datë 23.1.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	2396
Dekret i Presidentit nr. 28, datë 23.1.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	2397
Dekret i Presidentit nr. 29, datë 23.1.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	2397
Udhëzim i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 1, datë 11.1.2024	Për përcaktimin e programeve të formimit profesional që përfitojnë nga mbështetja financiare, për vitin 2024.....	2397
Vendim i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 22, datë 24.1.2024	Mbi miratimin e rregullores “Për zhvillimin e procedurave disiplinore për nëpunësit civilë gjyqësorë”	2398
Vendim i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit nr. 3, datë 19.1.2024	Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH.....	2406
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 369, datë 26.12.2023	Mbi caktimin e rolit të agentit të transferimit (<i>Shipping Agent</i>) për bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike Shqipëri–Kosovë.....	2408
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 370, datë 26.12.2023	Mbi miratimin e kërkesës së shoqërisë “Karavasta Solar” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së hipotekës) e aseteve fikse të saj.....	2410
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 371, datë 26.12.2023	Mbi licencimin e shoqërisë “Swiss Balancing Pool” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	2412
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 811/1, datë 25.1.2024	Mbi hyrjen në fuqi të një marrëveshjeje ndërkombëtare.....	2414
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 107/3, datë 24.1.2024	Për një ndryshim të VKM-së nr. 712, datë 11.1.2022, për shpronësimin për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit “Rikonstruksion i rrugës ‘Ago Celi’ dhe i ‘Rrugës së Re’, si dhe ‘Rikonceptimi i palestrës së lagjes ‘15 Shtatori’, Tepelenë”.....	2414
Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë nr. 5837, datë 9.11.2023	Për shpalljen të vdekur të shtetasit Xhavit Salia.....	2415
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Valmir Miri.....	2415

**DEKRET****Nr. 16, datë 23.1.2024****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, e nenit 93 të Kushtetutës; të neneve 13, 14, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Jonida Demir Shanaj (Hamitaj)
2. Gaia Gazmir Shanaj
3. Jonas Gazmir Shanaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET**Nr. 17, datë 23.1.2024****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, e nenit 93 të Kushtetutës; të neneve 13 dhe 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

I lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetas:

1. Lindita Bahri Gakovi (Topalli)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET**Nr. 18, datë 23.1.2024****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, e nenit 93 të Kushtetutës; të neneve 13, 14, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Arben Kamber Hasimllari
- 2.. Saloniko Arsen Çelaj
3. Amelia Eingel Saloniko Çelaj
4. Elisabeta Ali Sollaku
5. Marsela Arben Memaj
6. Matilda Shyqyri Merhori
7. Geralda Fran Kuka (Valca)
8. Noel Amarildo Kuka
9. Bjorn Amarildo Kuka

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj



DEKRET
Nr. 19, datë 23.1.2024

PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, e nenit 93 të Kushtetutës; të neneve 13 dhe 20 e në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Edi Mikail Joxhe
2. Megi Adrian Zhamo
3. Blendi Bekim Liçaj
4. Enkeleida Kujtim Llazo (Mustafa)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 20, datë 23.1.2024

PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, e nenit 93 të Kushtetutës; të neneve 13 dhe 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Irini Aristidhis Breiden (Mërkuri)
2. Ina Kastriot Roshi (Kalluqi)

3. Andja Arthur Nazifi
4. Idajet Ali Bogdani
5. Armand Shezidin Pashaj
6. Ermira Gramoz Agalliu
7. Taulant Fuat Groshi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 21, datë 23.1.2024

PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, e nenit 93 të Kushtetutës; të neneve 13, 14, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Martin Teodor Keko
2. Blerina Ramadan Schneider (Ajazi)
3. Geri Bujar Osmani
4. Oliver Arben Hasimllari
5. Vjola Vojo Sulaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj



DEKRET
Nr. 22, datë 23.1.2024

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 6 dhe 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Blendi Bexhet Arifi
2. Gëzim Musa Efendija
3. Bujar Bajram Islamaj
4. Adea Astrit Shllaku

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 23, datë 23.1.2024

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 6 dhe 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Denis Vegim Byci
2. Besart Florent Meqa

3. Lumturije Muarem Badalli (Rakaj)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 24, datë 23.1.2024

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 6 dhe 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Aldi Albert Batalli
2. Yllka Kadrush Godeni
3. Qendresë Esat Hoti (Gutaj)
4. Zenun Mustaf Hoxhaj
5. Dren Sadik Shporta

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj



DEKRET
Nr. 25, datë 23.1.2024

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 6 dhe 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Gent Dashnor Kabashi
2. Xhyllshene Hazer Hoxhaj (Xhoxhaj)
3. Fjolla Afrim Cahani
4. Mirushe Sadri Gashi (Pulaj)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 26, datë 23.1.2024

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 6 dhe 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Arbnore Sahit Dinarama (Hadri)
2. Liridona Hysen Çeku (Ibra)

3. Freskim Skender Lalaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 27, datë 23.1.2024

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 6 dhe 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Fadil Ismet Binaj
2. Fllaza Fadil Binaj
3. Fjolla Fadil Binaj Imeri
4. Fatlum Fadil Binaj
5. Fiton Fadil Binaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj



DEKRET
Nr. 28, datë 23.1.2024

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, e nenit 93 të Kushtetutës; të neneve 6 dhe 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Bashkim Bajram Islamaj
2. Avni Sadri Pulaj
3. Dashnore Musa Kusari (Efendija)
4. Gjyla Hajdar Binaj (Stajki)
5. Blerta Nuradin Kraja

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 29, datë 23.1.2024

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, e nenit 93 të Kushtetutës; të neneve 6 dhe 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Gazmir Gëzim Efendija

2. Endrit Gëzim Efendija

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

UDHËZIM
Nr. 1, datë 11.1.2024

PËR PËRCAKTIMIN E PROGRAMEVE
TË FORMIMIT PROFESIONAL QË
PËRFITOJNË NGA MBËSHTETJA
FINANCIARE, PËR VITIN 2024

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe nenit 2, pika 2, e kreut I, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 646, datë 5.10.2022, “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të formimit profesional nëpërmjet mbështetjes financiare të ofruar, sipas procedurave të konkurrimit, për kurset e formimit profesional të organizuara nga institucionet e formimit profesional, publike apo private”,

UDHËZOJ:

1. Të përfitojnë nga mbështetja financiare për vitin 2024, programet e formimit profesional në fushën “Programim”.

2. Në fushën “Programim” përfshihen: kodimi, programimi kompjuterik, zhvillimi i aplikacioneve, robotika, elektronika, shkenca e të dhënave, siguria kibernetike, inteligjenca artificiale, testimi i *software*-ve, dizajni i *software*-ve, dizajni i faqeve *web*, dizajni i përvojës së përdoruesit, dizajni i ndërfaqes së përdoruesit, mësimi makinerik/automatik, realiteti i shtuar, realiteti virtual ose algoritmet kompjuterike apo fusha të ngjashme të tjera.

3. Fondet për zbatimin e këtij programi për vitin 2024 të mbulohen nga fondet e programit të nxitjes së punësimit.

4. Udhëzimi nr. 1, datë 10.1.2023, “Për përcaktimin e programeve të formimit profesional



që përfitojnë nga mbështetja financiare, për vitin 2023”, shfuqizohet.

5. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Ervin Mete

VENDIM
Nr. 22, datë 24.1.2024

**MBI MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR ZHVILLIMIN E PROCEDURAVE
DISIPLINORE PËR NËPUNËSIT CIVILË
GJYQËSORË”**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të nenit 147/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë”, të neneve 69 dhe vijues të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të neneve 61, pika 2, shkronja “ë”, 90, pika 1, shkronja “ç” dhe “h”, 97, pika 1, shkronja “c”, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore “Për zhvillimin e procedurave disiplinore për nëpunësit civilë gjyqësorë”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETARE
Naureda Llagami

**RREGULLORE
PËR ZHVILLIMIN E PROCEDURAVE
DISIPLINORE PËR NËPUNËSIT CIVILË
GJYQËSORË**

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë parime të përgjithshme dhe rregulla më të detajuara për zhvillimin e procedurave disiplinore ndaj nëpunësve të tjerë civilë gjyqësorë.

Neni 2
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është rregullimi i procedurave të zbatueshme gjatë verifikimit të ankesave të paraqitura nga çdo person fizik dhe juridik, apo çdo nëpunës apo punonjës tjetër i gjykatës ndaj nëpunësve civilë gjyqësorë dhe hetimit të shkeljeve disiplinore, si dhe propozimit për fillimin e procedimit disiplinor, shqyrtimit e procedimeve disiplinore dhe vendimarrjeve në lidhje me to.

Neni 3
Përkufizime

Në rregullore termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Ditë” janë ditët kalendarike, me përjashtim të afateve nën 10 ditë, të cilat llogariten me ditë pune;
2. “Kancelari” është Kancelari i Gjykatës përkatëse, ku nëpunësi civil gjyqësor ushtron funksionet e tij;
3. “Kryetari” është Kryetari i Këshillit të Gjykatës;
4. “Këshilli” është Këshilli i Gjykatës;
5. “Ligji për qeverisjen” është ligji nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar;
6. “Ligji për nëpunësin civil” është ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;
7. “Ligji për pushtetin gjyqësor” është ligji nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;



8. Nëpunësit civilë gjyqësorë, procedura disiplinore ndaj të cilëve rregullohet sipas kësaj rregulloreje janë:

a) kryesekretari;

b) nëpunës të tjerë që punojnë në fushat e kërkimit ligjor dhe dokumentacionit, burimeve njerëzore, teknologjisë së informacionit, arkivit dhe marrëdhëniet me publikun, me jashtë ose me median;

c) nëpunësi i financës dhe buxhetit;

d) sekretari gjyqësor.

Neni 4

Parimet e procedurave disiplinore

Procedurat disiplinore ndaj nëpunësve civilë gjyqësorë zhvillohen në respektim të zbatimit të përshtatshëm dhe të balancuar të parimeve të mëposhtme:

a) së drejtës për një proces të rregullt, duke përfshirë dhe marrjen e një vendimi brenda një afati të arsyeshëm;

b) parimit të ligjshmërisë;

c) parimit të akuzës;

d) parimit të barazisë para ligjit;

e) parimit të transparencës;

f) prezumimit të pafajësisë;

g) parimit të dyshimit në favor të subjektit të procedimit disiplinor;

h) parimit të proporcionalitetit;

i) parimit të konfidencialitetit dhe të drejtës për jetë private dhe mbrojtjes së të dhënave personale;

j) shmangies së çdo konflikti interesi, në përputhje me rregullat e parashikuara në legjislacionin për parandalimin e konfliktit të intereseve.

Neni 5

Procedurat disiplinore

Procedurat disiplinore për nëpunësit civilë gjyqësorë, përfshijnë si vijon:

a) verifikimin paraprak të ankesave të paraqitura nga çdo person fizik apo juridik, duke përfshirë çdo nëpunës civil gjyqësor apo punonjës tjetër të gjykatës ndaj çdo nëpunësi civil gjyqësor sipas përcaktimeve në ligjin për pushtetin gjyqësor;

b) hetimin e shkeljeve disiplinore dhe propozimin për fillimin e procedimit disiplinor;

c) shqyrtimin e procedimeve disiplinore dhe kur është rasti, marrjen e masave disiplinore të parashikuara në ligj;

ç) ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për zbatimin dhe mbikëqyrjen e masave disiplinore, që vendosen në përfundim të një procedimi disiplinor;

d) ankimin ndaj vendimeve të organit kompetent.

KREU II

PROCEDURAT HETIMORE

Neni 6

Ankesa dhe kriteret për pranueshmërinë

1. Kancelari i Gjykatës përkatës shqyrton çdo ankesë të paraqitur sipas nenit 72, pikat 1 dhe 2 të ligjit për pushtetin gjyqësor.

2. Ankesa, së bashku me dokumentet shoqëruese, nëse ka, paraqitet personalisht, me anë të shërbimit postar apo postës elektronike. Kancelari i konfirmon ankuesit marrjen e ankesës brenda pesë ditëve nga marrja e saj.

3. Ankesa paraqitet në formë të shkruar, si dhe përmban:

a) gjenealogjet dhe adresën e ankuesit, si dhe kërkimin e ankuesit për ruajtjen e konfidencialitetit, nëse kërkohet prej tij;

b) përshkrim të rrethanave të faktit që pretendohen të kenë ndodhur;

c) emrin dhe mbiemrin e nëpunësit civil gjyqësor ose të dhëna mbi identifikimin e tij.

4. Ankesa pranohet për shqyrtim nga Kancelari, nëse plotëson kriteret e mëposhtme:

a) paraqitet në formën e përcaktuar, sipas parashikimeve të bëra në pikën 3 të këtij neni;

b) i referohet fakteve që kanë ndodhur brenda afatit të parashkrimit për hetimin disiplinor;

c) nuk përmban elemente abuzive, nuk është haptazi e pabazuar ose e përsëritur nga i njëjti ankues;

ç) bëhet ndaj sjelljes së nëpunësit civil gjyqësor, i cili ka qenë në detyrë në kohën kur shkelja e pretenduar ka ndodhur;

d) bëhet ndaj sjelljes së nëpunësit civil gjyqësor, të parashikuar si shkelje disiplinore nga legjislacioni në fuqi në kohën kur shkelja e pretenduar ka ndodhur;



dh) bëhet ndaj sjelljes së nëpunësit civil gjyqësor që, nëse provohet se është kryer, përbën shkelje disiplinore të parashikuar nga ligji.

5. Kancelari vendos verifikimin e ankesës ose arkivimin e saj nëse nuk përmbush një ose më shumë nga kriteret e pranueshmërisë të parashikuar në këtë nen. Vendimi për arkivimin e ankesës, në formë të arsyetuar, i njoftohet ankuesit dhe nëpunësit civil gjyqësor, brenda 15 ditëve nga marrja e vendimit.

Neni 7

Shqyrtimi paraprak i ankesës

1. Pas verifikimit të ankesës, Kancelari, brenda gjashtë muajve nga dita e marrjes së ankesës, vendos:

- a) të arkivojë ankesën;
- b) të fillojë hetimin disiplinor.

2. Vendimi për arkivimin e ankesës, në formë të arsyetuar, i njoftohet ankuesit dhe nëpunësit civil gjyqësor, brenda 15 ditëve nga marrja e vendimit.

3. Tërheqja e ankesës nga ankuesi nuk sjell arkivimin e saj, si dhe nuk sjell mbylljen e një hetimi të filluar, nëse Kancelari vlerëson që pretendimi ka shkaqe të mjaftueshme për kryerjen e hetimit me iniciativën e tij.

Neni 8

Fillimi i hetimit disiplinor

1. Kancelari i Gjykatës fillon hetimin disiplinor nëse ka dyshime të arsyeshme, bazuar në fakte dhe provat e mbledhura, se shkelja mund të jetë kryer. Vendimi i arsyetuar për fillimin e hetimit disiplinor i njoftohet ankuesit, nëpunësit civil gjyqësor dhe Këshillit të Gjykatës.

2. Vendimi për fillimin e hetimit disiplinor përmban:

- a) të dhënat identifikuese të nëpunësit civil gjyqësor;
- b) objektin e hetimit, duke parashtruar shkeljet e dyshuara;
- c) parashtrimin e rrethanave të faktit të pretenduar;
- ç) provat e disponueshme;
- d) periudhën kohore të hetimit;
- dh) parashtrimin e të drejtave të nëpunësit civil gjyqësor në lidhje me hetimin, si dhe të drejtën për të dorëzuar parashtesa dhe dokumente mbështetëse

brenda një muaji nga marrja e njoftimit për vendimin e fillimit të hetimit.

3. Kancelari fillon hetimin me iniciativën e tij, brenda gjashtë muajve nga marrja e informacionit dhe fakteve të rëndësishme, bazuar në të dhëna thelbësore që rezultojnë nga burime të besueshme, mbi bazën e të cilave lind dyshimi i arsyeshëm se shkelja mund të jetë kryer.

4. Informacionet që përftohen nga media ose nga ankues anonimë mund të shërbejnë si indicie për të filluar një hetim, kryesisht nëse përmbushen kriteret e parashikuara në nenin 6, pika 4, shkronjat “b”, “ç”, “d” dhe “dh” të kësaj rregulloreje.

5. Kancelari thërret dëshmitarë dhe mbledh të dhëna, dokumente dhe prova nga institucione publike apo subjekte private, dëshmitarë, dhe/ose nëpunësi civil gjyqësor ose mbikëqyrësit e tyre, dhe ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për të hetuar dhe përcaktuar nëse shkelja e pretenduar ka ndodhur.

6. Në rast se gjatë hetimit ngrihen dyshime të arsyeshme se ka ndodhur një shkelje tjetër, Kancelari merr vendim për të shtuar ose ndryshuar objektin e hetimit.

7. Kancelari mund të vendosë shtyrjen e afatit gjashtëmuajor të hetimit disiplinor edhe me gjashtë muaj të tjerë, në rastet e mëposhtme:

- a) kur nëpunësi civil gjyqësor është i sëmurë ose kur nuk mund të paraqitet për shkaqe të justifikuara të vlerësuara rast pas rasti nga Kancelari i Gjykatës;
- b) kur vendoset zgjerimi i hetimit disiplinor, ose kur ndryshon shkaku ligjor i hetimit;
- c) në raste të tjera komplekse.

8. Vendimi për ndryshimin apo shtimin e objektit të hetimit, shtyrjen e afatit të hetimit, mbylljen apo rifillimin e hetimit, i njoftohet palëve brenda pesë ditëve nga marrja e tyre.

Neni 9

Pezullimi i hetimeve dhe procedimit disiplinor

1. Kancelari gjatë hetimit të procedimit disiplinor, apo Këshilli i Gjykatës gjatë ecurisë së procedurës disiplinore, pezullon hetimin ose procedimin disiplinor nëse janë duke u kryer procedura penale, administrative ose civile:

- a) në të cilat, njëra nga palët është nëpunësi civil gjyqësor që i atribuohet shkelja;
- b) shkelja e dyshuar lidhet me të njëjtat fakte.



2. Hetimi ose procedura disiplinore pezullohet deri në dhënien e vendimit gjyqësor përfundimtar.

3. Ankuesi, gjatë fazës së hetimit, nëpunësi civil gjyqësor përkatës, gjykatat dhe prokuroritë njoftohen me shkrim për vendimin e pezullimit. Gjykatat dhe prokuroritë e interesuara dorëzojnë pa vonesë çdo vendim që është marrë për procedurat përkatëse.

4. Vendimi përfundimtar për pafajësinë ose rrëzimin e kërtimeve ndaj nëpunësit civil gjyqësor, në kuadër të një procesi penal, administrativ ose civil nuk përjashton hetimin ose caktimin e përgjegjësisë disiplinore të nëpunësit civil gjyqësor.

5. Kancelari apo Këshilli i Gjykatës u referohet vetëm fakteve, mbi të cilat bazohet vendimi përfundimtar, dhe jo dënimit ose pafajësisë së dhënë në vendim.

6. Vendimi për pezullimin e hetimit nuk ankimohet.

Neni 10

Marrja në pyetje

1. Kur Kancelari vlerëson se marrja në pyetje e nëpunësit civil gjyqësor, dëshmitarëve ose personave të tjerë paraqet rëndësi për hetimin, i njofton ata lidhur me kohën dhe vendin e seancës së marrjes në pyetje.

2. Kancelari siguron që seanca e marrjes në pyetje të regjistrohet në audio, sipas procedurës së mëposhtme:

a) personi që merret në pyetje informohet se seanca përkatëse do të regjistrohet në audio;

b) regjistrimi përmban gjenealogjetet e personave që janë thirrur për t'u pyetur;

c) në rast ndërprerjeje të seancës së marrjes në pyetje, përpara se regjistrimi audio të përfundojë, regjistrohet ora, shkaku i ndërprerjes, si dhe ora e rifillimit të seancës;

ç) në përfundim të seancës, personi i marrë në pyetje mund të saktësojë çdo gjë që ka deklaruar, si dhe të shtojë gjithçka që vlerëson. Më kërkesën e personit të marrë në pyetje, regjistrimi dëgjohet, si dhe regjistrohen korrigjimet dhe shpjegimet e tij në lidhje me deklaratimet e mëparshme. Në mbarim të seancës së marrjes në pyetje regjistrohet ora e përfundimit të saj.

3. Regjistrimi audio i seancës së marrjes në pyetje përmbledhet në procesverbal, si dhe mund të transkribohet. Nëpunësi civil gjyqësor nënshkruan

procesverbalin e marrjes në pyetje, si dhe transkriptimin e regjistrimit audio nëse është bërë i mundur.

4. Regjistrimi audio, transkriptimi i tij, nëse është bërë i mundur, si dhe procesverbali i seancës së marrjes në pyetje bëhen pjesë e dosjes.

Neni 11

Dokumentacioni i hetimit

1. Kancelari dokumenton çdo veprim hetimor me procesverbal.

2. Procesverbali përmban:

a) emrin dhe mbiemrin e Kancelarit që kryen veprimin;

b) datën e kryerjes së veprimit;

c) subjektin dhe objektin e veprimit;

ç) pjesëmarrësit;

d) përshkrimin e hollësishëm të veprimit të kryer;

dh) nënshkrimin e Kancelarit në fund të çdo faqeje, si dhe të personave që marrin pjesë në këto veprime.

Neni 12

Përfundimi i hetimit disiplinor

1. Në përfundim të hetimeve të kryera sipas afateve ligjore, Kancelari përgatit raportin e hetimit disiplinor, i cili përmbledh faktet, listën e provave, rëndësinë e tyre, si dhe konkluzionet që argumentojnë se këto fakte përbëjnë shkelje të detyrimeve të nëpunësve civilë gjyqësorë, sipas ligjit "Për nëpunësin civil".

2. Bazuar në parashtrimet e raportit të hetimit disiplinor, Kancelari i paraqet Këshillit të Gjykatës kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor dhe propozimin për caktimin e masës disiplinore, brenda gjashtë muajve nga fillimi i hetimeve.

3. Raporti i hetimit disiplinor, si dhe materialet/dokumentet e mbledhura gjatë këtij hetimi, i njoftohen nëpunësit civil gjyqësor brenda pesë ditëve nga data e marrjes së vendimit për fillimin e procedimit disiplinor.

Neni 13

Mbyllja e hetimit disiplinor

1. Kancelari i paraqet Këshillit të Gjykatës propozimin për mbylljen e hetimit disiplinor, brenda gjashtë muajve nga fillimi i tyre, nëse provohet se



pretendimet janë të pabazuara ose provat e mbledhura dhe rezultatet e hetimit të çojnë drejt përfundimit se:

a) provat janë të pamjaftueshme për të provuar kryerjen e shkeljes disiplinore;

b) çështja ka qenë objekt i një hetimi të mëparshëm që është mbyllur ose për të cilën është dhënë vendim i formës së prerë, në kuadër të një procedimi disiplinor;

c) çështja është parashkruar në kohën kur është filluar hetimi, për shkak të kalimit të afateve;

ç) nëpunësit civil gjyqësor i mbaron statusi sipas parashikimeve të ligjit për nëpunësin civil;

d) nëpunësi civil gjyqësor ka vdekur.

2. Këshilli i Gjykatës shqyrton propozimin për mbylljen e hetimit brenda një muaji nga data e depozitimit të kërkesës, sipas rregullave të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor për procedurën e funksionimit të mbledhjes së Këshillit të Gjykatës.

3. Kancelari i njofton vendimin e Këshillit, nëpunësit civil gjyqësor ose përfaqësuesit të tij dhe ankuesit. Vendimi përmban arsyet për mbylljen e hetimit, sipas pikës 1 të këtij neni.

4. Në rastet kur nëpunësit civil gjyqësor ka dalë në pension, Kancelari harton raportin përfundimtar, i cili përmban përmbledhje të pretendimeve për shkeljen disiplinore, provat e mbledhura dhe konkluzionet. Raporti mbyll procesin hetimor, si dhe iu bëhet me dije palëve.

5. Faktet e zbuluara gjatë hetimit, të cilat nuk justifikojnë fillimin e procedimit disiplinor, por që mund të jenë të rëndësishme për vlerësimin etik dhe profesional, i paraqiten organit kompetent për shqyrtim të mëtejshëm.

Neni 14

Rihapja e hetimit disiplinor

1. Në rast se pas përfundimit të afatit të hetimit, zbulohen prova të reja, të cilat tregojnë në mënyrë të arsyeshme se shkelja ka ndodhur, Kancelari rihap hetimin, me kusht që afati i parashkrimit të mos ketë përfunduar.

2. Kancelari i paraqet propozimin për caktimin e masës disiplinore ose propozimin për mbylljen e hetimit brenda gjashtë muajve nga vendimi për rifillimin e hetimit.

Neni 15

Ankimi i mosveprimit administrativ

Në rast se Kancelari nuk vepron brenda afateve të parashikuara në pikat 2 deri në 4, të nenit 71, të ligjit për pushtetin gjyqësor, nëpunësi civil gjyqësor ka të drejtë të ankimojë mosveprimin administrativ në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

KREU III

PROCEDIMI DISIPLINOR

Neni 16

Paraqitja e kërkesës

1. Kërkesa për fillimin e procedimit disiplinor depozitohet nga Kancelari në zyrën e Kryetarit të Gjykatës. Bashkë me kërkesën depozitohet raporti i hetimit dhe i gjithë dokumentacioni përkatës i mbledhur gjatë procedurës hetimore.

2. Pas regjistrimit në regjistrin përkatës, kërkesa e Kancelarit i përcillet Kryetarit, i cili kalon çështjen në mbledhjen e Këshillit të Gjykatës.

3. Për çdo çështje të regjistruar për shqyrtim formohet një dosje e veçantë, në të cilën administrohet dhe numërohet, i gjithë dokumentacioni, i krijuar dhe i mbledhur gjatë procedurës së shqyrtimit të kësaj çështjeje në Këshill.

Neni 17

Detyrat e nëpunësve civilë gjyqësorë

1. Kryetari mbështetet në veprimtarinë e tij nga nëpunës civilë gjyqësorë, të cilët ushtrojnë veprimtari ndihmëse, duke përmbushur këto detyra, por pa u kufizuar në to:

a) regjistrimin e të dhënave në lidhje me çështjet e paraqitura për shqyrtim në Këshill;

b) përcjelljen e çështjes te Kryetarit për të vijuar, sa më shpejt të jetë e mundur, me procedurat për mbledhjen e Këshillit;

c) mbajtjen e procesverbalit të mbledhjeve të Këshillit;

ç) mbajtjen e të gjitha komunikimeve të vazhdueshme, të njoftimeve dhe të akteve shkresore, me subjektet ankuese/kërkuese ose me përfaqësuesit e tyre, gjatë shqyrtimit të çështjes, mbi bazën e urdhërimeve të Kryetarit ose të Këshillit;



d) redaktimin e akteve të Këshillit në këndvështrimin gjuhësor;

dh) numërtimin e vendimit pas përfundimit të plotë të shqyrtimit të çështjes dhe dhënies së vendimit;

e) marrjen e masave për njoftimin e akteve sipas urdhërimeve të Kryetarit;

ë) marrjen në dorëzim të dosjes nga Këshilli në përfundim të procedurës dhe depozitimin e saj për arkivim;

f) ndjek procedurën e ankimit ndaj vendimit të Këshillit, mbi ankimin e palëve në procedurë, përveç kur me vendim të Këshillit vendoset ndryshe;

g) vënien në dispozicion të Këshillit të çdo lloj informacioni, dokumentacioni dhe statistike sipas kërkesës së tyre, për qëllime të procedurës.

2. Me fillimin e procedurës, sipas kësaj rregulloreje, Kryetari cakton nëpunësin civil gjyqësor përgjegjës për kryerjen e detyrave të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

3. Nëpunësi civil gjyqësor i caktuar sipas pikës 2 të këtij neni, në çdo kohë, kur merr dijeni për ekzistencën e një konflikti interesi ose pengese ligjore, në lidhje me një çështje, është i detyruar të deklarojë natyrën e konfliktit të interesit ose pengesës dhe të heqë dorë nga pjesëmarrja në veprimtarinë e Këshillit gjatë shqyrtimit të kësaj çështjeje. Kërkesa për dorëheqje i drejtohet Kryetarit, i cili kur vendos pranimin, cakton dhe nëpunësin civil gjyqësor zëvendësues.

Neni 18

Mënyrat e njoftimit të akteve

Aktet e procedurës sipas kësaj rregulloreje i njoftohen palëve në një ose disa nga format e mëposhtme:

a) personalisht ose përfaqësuesit ligjor kur janë të pranishëm në çastin e shpalljes së aktit;

b) me postë të porositur në adresën e vendit të punës të marrësit;

c) në adresën postare elektronike të depozituar zyrtarisht nga palët.

Neni 19

Përbërja e Këshillit të Gjykatës

1. Këshilli i Gjykatës, në një procedim disiplinor, si rregull, përbëhet nga:

a) Kryetari, i cili vepron si kryetar i Këshillit të Gjykatës;

b) zëvendëskryetari;

c) një nëpunës i lartë civil gjyqësor i Këshilli të Lartë Gjyqësor, i caktuar nga ky i fundit.

2. Në rastet e mungesës së Kryetarit ose zëvendëskryetarit, përbërja e Këshillit të Gjykatës caktohet në bazë të rregullave të parashikuara në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor për procedurën e funksionimit të mbledhjes së Këshillit të Gjykatës.

Neni 20

Shqyrtimi paraprak i çështjes

1. Këshilli i Gjykatës, pas shqyrtimit paraprak të çështjes, vendos kalimin e çështjes në seancë dëgjimore ose rrëzimin e kërkesës për fillimin e procedimit disiplinor pa seancë dëgjimore, në rastet e parashikuara nga neni 74, pika 1 të ligjit për pushtetin gjyqësor.

2. Në rastin e kalimit të çështjes në seancë dëgjimore, Këshilli vendos për caktimin e datës për zhvillimin e seancës dëgjimore brenda një muaji nga dita e depozitimit të dosjes nga Kancelari.

3. Në rastin e vendimit për caktimin e seancës dëgjimore, Këshilli mban në vlerësim:

a) njoftimin e palëve në procedurë për datën e seancës, të paktën 15 ditë para saj, si dhe;

b) afatin brenda të cilit nëpunësi civil gjyqësor paraqet parashtrësit me shkrim.

4. Këshilli rrëzon kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor pa seancë dëgjimore sipas pikës 1, të këtij neni, me vendim të arsyetuar me shkrim, i cili përmban dhe shkaqet e rrëzimit të kërkesës për fillim procedimi disiplinor.

5. Vendimet sipas këtij neni i njoftohen palëve në procedurë.

Neni 21

Të drejtat e nëpunësit civil gjyqësor pas vendimit të caktimit të seancës dëgjimore

1. Kryetari, bashkë me njoftimin e vendimit të Këshillit për caktimin e seancës dëgjimore, i bën të ditur nëpunësit civil gjyqësor të drejtat, si vijon:

a) për t'u njohur me dokumentet e dosjes dhe për të marrë kopje të tyre, brenda pesë ditëve nga paraqitja e kërkesës së tij;



- b) për të paraqitur një parashtrësë me shkrim brenda një afati të caktuar;
- c) për të marrë pjesë në seancë dëgjimore;
- d) për të thirrur dëshmitarë që mund të dëshmojnë fakte me interes për çështjen;
- e) për të paraqitur prova;
- f) për t'u përfaqësuar, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative;
- g) për të kërkuar përjashtimin e një ose disa anëtarëve të Këshillit, nga pjesëmarrja në shqyrtimin e procedurës disiplinore, vetëm gjatë fazës paraprake të procesit;
- h) për kompensimin e shpenzimeve të arsyeshme ligjore, në raste kur nuk vendoset masë disiplinore.

Neni 22

Publiciteti i seancës

1. Seanca dëgjimore është publike.
2. Prania e shtypit të shkruar dhe elektronik në sallë, gjatë seancës dëgjimore publike, është e lejuar, për sa kohë nuk pengon zhvillimin normal të seancës. Regjistrimi audio, video dhe fotografimi gjatë seancës, si rregull, nuk lejohet. Regjistrimi audio, video dhe fotografimi realizohen sipas rregullave të hollësishme të marrëdhënieve me median, të miratuara me rregullore të posaçme.
3. Këshilli, kryesisht ose me kërkesë të palëve, mund të vendosë zhvillimin e seancës me dyer të mbyllura, në rastet:
 - a) kur publiciteti i seancës mund të dëmtojë moralin e shoqërisë ose mund të bëjë publike të dhëna sekrete në interes të sigurisë kombëtare, nëse kjo kërkohet nga autoritetet kompetente;
 - b) kur është e nevojshme të mbrohet e drejta e jetës private, të mbrohen të dhënat personale të nëpunësit civil gjyqësor ose një personi tjetër;
 - c) kur nga publiku ka shfaqje që prishin zhvillimin normal të seancës dëgjimore.
4. Kur Këshilli zhvillon mbledhje me dyer të mbyllura, publiku dhe media largohen nga salla e mbledhjeve.

Neni 23

Zhvillimi i seancës dëgjimore

1. Kryetari, pasi deklaron hapjen e seancës dëgjimore, verifikon kuorumin për zhvillimin e mbledhjes. Nëse ndonjë anëtar i Këshillit merr pjesë

në mbledhje në distancë, Kryetari merr masa për realizimin e këtij komunikimi.

2. Pas hapjes së seancës dëgjimore, Kryetari si drejtues i seancës, kryen këto veprime procedurale:

- a) verifikon legjitimitimin procedural të palëve dhe të përfaqësuesve të tyre, sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative;
- b) pyet palët nëse kanë ndonjë kërkesë procedurale, që lidhet me legjitimitimin apo zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor;
- c) deklaron të hapur shqyrtimin e procedimit disiplinor;
- d) u bën të njohur palëve që përmbajtja e parashtrimeve me shkrim nuk përsëritet gjatë seancës dëgjimore;

e) u jep të drejtën e fjalës sipas radhës:

i. Kancelarit, i cili paraqet argumentet që shkelja disiplinore është kryer dhe propozon masën disiplinore;

ii. Nëpunësit civil gjyqësor të proceduar ose përfaqësuesit të tij, për të paraqitur argumentet mbrojtëse;

f) komunikon vendimin e Këshillit:

- i. për shtyrjen e seancës dëgjimore;
- ii. për administrimin e provave, që plotësojnë kushtet e pranueshmërisë, kanë lidhje me objektin e procedimit dhe kanë rëndësi në zgjidhjen e drejtë të çështjes;
- iii. çdo vendim tjetër të marrë gjatë seancës dëgjimore;

iv. për mbylljen e fazës së shqyrtimit;

g) fton palët për pretendimet e fundit;

h) shpall vendimin përfundimtar të procedimit.

3. Për zhvillimin dhe dokumentimin e seancës dëgjimore respektohen, me aq sa është e mundur, dhe rregullat e parashikuara në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor për procedurën e funksionimit të mbledhjes së Këshillit të Gjykatës.

Neni 24

Shqyrtimi i kërkesës për procedim disiplinor

Këshilli, gjatë zhvillimit të procedimit disiplinor, në zbatim të përcaktimeve të Kodit të Procedurave Administrative, kryen veprimet e mëposhtme:

- a) shqyrton të gjithë faktorët që kanë rëndësi për çështjen;
- b) merr prova shtesë, duke përfshirë edhe thirrjen e dëshmitarëve;



c) kur e konsideron të përshtatshme, thërret ekspertë;

ç) kryen çdo veprim tjetër që vlerësohet i nevojshëm ose i përshtatshëm për trajtimin e çështjes.

Neni 25

Marrja e vendimit në përfundim të procedimit disiplinor

1. Në përfundim të seancës dëgjimore, Këshilli vendos:

a) pranimin e kërkesës dhe caktimin e masës disiplinore;

b) rrëzimin e kërkesës për procedim disiplinor për shkak se faktet e pretenduara nuk kanë ndodhur ose ato nuk përbëjnë shkelje disiplinore.

2. Vendimi i Këshillit merret me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve, nëpërmjet një votimi të hapur. I pari voton nëpunësi civil i nivelit të lartë i caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Kryetari voton i fundit. Gjatë marrjes së vendimit, zbatohen sa është e mundur, dhe rregullat e parashikuara në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor për procedurën e funksionimit të mbledhjes së Këshillit të Gjykatës.

3. Këshilli nuk është i detyruar t'i qëndrojë masës disiplinore të propozuar dhe jep vendim të arsyetuar me shkrim brenda një muaji nga përfundimi i seancës.

4. Vendimi përfundimtar i Këshillit përmban, të paktën këto të dhëna:

a) organin kompetent për propozimin e fillimit të procedimit disiplinor;

b) nëpunësin civil gjyqësor, subjekt të procedimit disiplinor;

c) objektin dhe bazën ligjore të kërkesës;

ç) procedurën e zhvilluar në Këshill;

d) rrethanat e faktit siç janë konstatuar gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore;

dh) parashtrimet e përmbledhura të palëve;

e) arsyetimin e përfundimeve të nxjerra nga Këshilli në raport me faktin, provat dhe ligjin e zbatueshëm;

ë) pjesën vendimmarrëse dhe dispozitat ligjore ku bazohet vendimi;

f) të drejtën e ankimit, afatin për paraqitjen së tij dhe organin kompetent;

g) datën e shpalljes së vendimit;

gj) nënshkrimin e anëtarëve të Këshillit.

Neni 26

E drejta për ankim

Nëpunësi civil gjyqësor dhe Kancelari kanë të drejtën e ankimit ndaj vendimit të Këshillit të Gjykatës, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar, në Gjykatën Administrative të Apelit.

KREU IV

PEZULLIMI NGA DETYRA

Neni 27

Paraqitja e kërkesës

1. Kërkesa për pezullimin nga detyra të nëpunësit civil gjyqësor, ndaj të cilit ka filluar hetimi ose procedimi disiplinor, paraqitet nga Kancelari, sipas nenit 77 të ligjit për pushtetin gjyqësor. Kërkesa duhet të jetë e argumentuar dhe i bashkëlidhet i gjithë dokumentacioni përkatës provues.

2. Pas regjistrimit, kërkesa e paraqitur gjatë hetimit ose bashkë me kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor, i kalon menjëherë për shqyrtim Kryetarit të Këshillit.

3. Këshilli mund të vendosë edhe kryesisht pezullimin e nëpunësit civil gjyqësor ose marrjen e çdo mase tjetër të përshtatshme dhe proporcionale.

Neni 28

Shqyrtimi i kërkesës

1. Kryetari ose çdo anëtar i Këshillit, pas shqyrtimit të kërkesës ose ardhjes në dijeni të rrethanave të parashikuara në nenin 77 të ligjit për pushtetin gjyqësor, i propozon Këshillit:

a) rrëzimin e kërkesës; ose

b) pranimin e kërkesës dhe pezullimin nga detyra; ose

c) pranimin e kërkesës dhe marrjen e një mase tjetër të përshtatshme dhe proporcionale.

2. Këshilli merr vendim në lidhje me kërkesën brenda 3 ditëve nga paraqitja e saj.

3. Nëpunësi civil gjyqësor ka të drejtë të ankimojë vendimin për pezullimin nga detyra në Gjykatën e Apelit Administrativ. Paraqitja e ankimit nuk pezullon ekzekutimin e vendimit.

4. Këshilli vepron në të njëjtën procedurë edhe për rastet e ndryshimit të kohëzgjatjes apo revokimit



të pezullimit. Kryetari ose çdo anëtar i Këshillit i propozon Këshillit të Gjykatës, sipas rastit:

- a) ndryshimin e kohëzgjatjes së pezullimit;
- b) revokimin e pezullimit; ose
- c) lënien në fuqi të pezullimit.

5. Nëpunësi civil gjyqësor paguhet me pagë të plotë gjatë periudhës së pezullimit.

6. Kryetari dhe Kancelari i Gjykatës marrin masat e duhura për kthimin nga nëpunësi civil gjyqësor të 50% të pagës së përfutur gjatë periudhës së pezullimit në rastet e përcaktuara në nenin 68, pika 3, shkronja “a” të ligjit për pushtetin gjyqësor.

KREU V

EKZEKUTIMI I MASËS DISIPLINORE

Neni 29

Ekzekutimi i masës disiplinore

1. Vendimi për caktimin e masës disiplinore ekzekutohet në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative.

2. Njësia përgjegjëse e burimeve njerëzore pranë Gjykatës merr të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e menjëhershëm të masës disiplinore, si dhe është përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe zbatimin e saj.

3. Me vendim të njësisë së burimeve njerëzore bëhet deklarimi i shuarjes së masës disiplinore, kryesisht apo me kërkesë të nëpunësit civil gjyqësor, brenda pesë ditëve nga plotësimi i afatit ligjor. Një kopje e vendimit i njoftohet nëpunësit civil gjyqësor brenda 5 ditëve nga marrja e tij.

4. Masa fshihet nga dosja e personelit dhe regjistri përkatës.

5. Vendimet përfundimtare për masat disiplinore mbahen në dosjen personale të nëpunësit civil gjyqësor dhe regjistrohen në Regjistrin Qendror të Personelit.

Neni 30

Arkivimi i praktikës dokumentare

Praktika dokumentare arkivohet në Zyrën e Protokoll-Arkivit të Këshillit, në përputhje me legjislacionin në fuqi mbi arkivat.

KREU VI

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 31

Modeli i formularit të ankesës

1. Këshilli i Gjykatës, brenda 60 ditëve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, sipas nenit 12 të saj, miraton modelin e formularit të ankesës, i cili përmban të paktën këto elemente:

a) gjeneralitetet e ankuesit, si dhe nëse ankuesi kërkon konfidencialitetin e identitetit të tij;

b) emrin dhe mbiemrin, dhe pozicionin e punës së nëpunësit civil gjyqësor ose të dhëna të mjaftueshme për identifikimin e tij, i cili pretendohet se ka kryer shkeljen disiplinore;

c) përshkrimin e veprimit ose sjelljes, ditën/ët kur është kryer veprimi, që pretendohet se përbën shkelje disiplinore dhe rrethanat e kryerjes së tij;

d) listën e dokumenteve që provojnë shkeljen e pretenduar.

2. Modeli i formularit publikohet në faqen zyrtare të gjykatës, me qëllim lehtësimin e paraqitjes së ankesave.

VENDIM

Nr. 3, datë 19.1.2024

BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH

Mbështetur në nenin 44, pika 4, të ligjit nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, të ndryshuar; në kreun I, nenit 22, pika 4, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, të ndryshuar; në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017, “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”, në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 21, datë 6.2.2023, të kryetarit të Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar ‘Sekret shtetëror’ në AIDSSH”, i ndryshuar me urdhrin nr. 56, datë 23.3.2023, “Për një ndryshim në urdhrin nr. 21, datë 6.2.2023, “Për krijimin e komisionit të deklasifikimit dhe



zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’ në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, me vendimin nr. 3, datë 19.1.2024, si më poshtë:

I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. Arkivi i Autoritetit, Fondi Dega IV, dosje pune nr. 24542 “Morava”, me 135 (njëqind e tridhjetë e pesë) fletë. Dosja daton në vitet 1987–1988. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

2. Arkivi i Autoritetit, Fondi Ushtria, dosje pune dhe personale nr. 9317 “Blini”, me 2 volume, në total 25 (njëzet e pesë) fletë. Dosja daton në vitet 1977–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

3. Arkivi i Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Dibër, dosje pune dhe personale nr. 4659 “Peshkatari”, me 2 volume, në total 216 (dyqind e gjashtëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1985–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

4. Arkivi i Autoritetit, Fondi Dega IV, dosje pune nr. 24192 “Besniku”, me 34 (tridhjetë e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1986–1987. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

5. Arkivi i Autoritetit, Fondi Dega Punëve të Brendshme Librazhd, dosje pune dhe personale nr. 310 “Tutiusi”, me 2 volume, në total 176 (njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitet 1965–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

6. Arkivi i Autoritetit, Fondi Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë, dosje pune dhe personale nr. 204 “Akili”, me 2 volume, në total 64 (gjashtëdhjetë e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1987–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

7. Arkivi i Autoritetit, Fondi Dega IV, dosje pune nr. 24193 “Peshkatari”, me 109 (njëqind e nëntë) fletë. Dosja daton në vitet 1986–1987. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

8. Arkivi i Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Lushnjë, dosje pune dhe personale nr. 626 “Dëshira”, me 3 volume, në total 285 (dyqind e tetëdhjetë e pesë) fletë. Dosja daton në vitet 1966–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

9. Arkivi i Autoritetit, Fondi Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë, Libri i Evidencës së Punëtorit Operativ në Zonë, në ngarkim të S.L., në total 225 (dyqind e njëzet e pesë) fletë. Dosja daton në vitet

1952–1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

10. Arkivi i Autoritetit, Fondi Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë, dosje formulare nr. 8025, në ngarkim të Dh.T., në total 90 (nëntëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1980–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

11. Arkivi i Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, dosje pune dhe personale nr. 546 “Karafili kuq”, me 2 volume, në total 178 (njëqind e shtatëdhjetë e tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1953–1979. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

12. Arkivi i Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Vlorë, dosje formulare nr. 403, në ngarkim të I.B., me 241 (dyqind e dyzet e një) fletë. Në brendësi të dosjes gjendet fashikulli nr. 34, me 36 (tridhjetë e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitet 1975–1984. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

13. Arkivi i Autoritetit, Fondi Operativ, Dosje pune, formulare dhe personale nr. 2911 “Bisku blirit”, me 3 volume, në total 234 (dyqind e tridhjetë e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1948–1983. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

14. Arkivi i Autoritetit, Fondi Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë, dosje personale dhe pune nr. 2809 “Lexusi”, me 2 volume, në total 337 (treqind e tridhjetë e shtatë) fletë. Dosja daton në vitet 1963–1985. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

15. Arkivi i Autoritetit, Fondi Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë, dosje personale dhe pune nr. 12161 “Furtuna”, me 2 volume, në total 115 (njëqind e pesëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1980–1987. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

16. Arkivi i Autoritetit, Fondi Operativ, Dosje personale nr. 4392 “Furça”, me 34 (tridhjetë e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1958–1985. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

17. Arkivi i Autoritetit, Fondi Operativ, dosje pune dhe personale nr. 46 “Telemaku”, me 2 volume, në total 294 (dyqind e nëntëdhjetë e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1949–1981. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

18. Arkivi i Autoritetit, Fondi Ersekë, dosje pune dhe personale nr. 1382 “Trebeshina”, me 2 volume, në total 375 (treqind e shtatëdhjetë e pesë) fletë.



Dosja daton në vitet 1971–1987. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

19. Arkivi i Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Ersekë, Dosje personale dhe pune nr. 590 “Maqinisti”, me 2 volume, në total 364 (treqind e gjashtëdhjetë e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1959–1981. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

20. Arkivi i Autoritetit, Fondi të Arratisur, fashikull nr. 278, në ngarkim të A.K., me 480 (katërqind e tetëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1944–1976. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

21. Arkivi i Autoritetit, Fondi Operativ, dosje formulare nr. 583, “Buna”, me 70 (shtatëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1947–1950. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

22. Arkivi i Autoritetit, Fondi të Arratisur, dosje kërkimi nr. 10, në ngarkim të N.L., me 55 (pesëdhjetë e pesë) fletë. Dosja daton në vitet 1944–1950. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

23. Arkivi i Autoritetit, Fondi të Arratisur, dosje kërkimi nr. 44, në ngarkim të Sh.L., me 20 (njëzet) fletë. Dosja daton në vitet 1952–1988. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

24. Arkivi i Autoritetit, Fondi të Huajt, dosje përpunimi nr. 1160, në ngarkim të M.T., me 259 (dyqind e pesëdhjetë e nëntë) fletë. Dosja daton në vitet 1967–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

25. Arkivi i Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, vendim për veçimin dhe arkivimin e dosjes nr. 632 të Dh.A., me 1 (një) fletë. Dokumenti daton në vitet 1991. Niveli i klasifikimit të dokumentit është “Sekret”.

1. Arsyeja e deklasifikimit të dokumenteve të sipërcituara është:

- Mbështetur në nenin 44, pika 4 të ligjit 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenin 22, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, si dhe në vendimin e Autoritetit nr. 31, datë 24.1.2023, pika 1 e dispozitivit.

2. Ngarkohet sekretari i KDZH-së, të bëjë evidentimet përkatëse në regjistër, të vendosë vulën përkatëse mbi dokumentet e deklasifikuara dhe të hartojë bibliografinë e informacionit të deklasifikuar.

3. Kopja e bibliografisë së informacionit të deklasifikuar, t’i dërgohet zyrtarisht Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar.

4. Të bëhet publikimi i dokumenteve të deklasifikuar në faqen zyrtare të internetit të AIDSSH-së dhe në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR I KDZH-së
Gentiana Sula

VENDIM

Nr. 369, datë 26.12.2023

MBI ÇAKTIMIN E ROLIT TË AGJENTIT TË TRANSFERIMIT (*SHIPPING AGENT*) PËR BASHKIMIN E TREGJEVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE SHQIPËRI-KOSOVË

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 5, germa “k”, dhe 6, germa “k”, të “Rregullores së kërkesave dhe procedurave për përcaktimin e operatorit të emëruar të tregut të energjisë elektrike (NEMO)”, si dhe rolet e përgjegjësitë e NEMO-s dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë në tregun e bashkuar miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 40, datë 6.3.2020, si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.12.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2305/11 prot., datë 21.12.2023, të përgatitur nga drejtoritë teknike “Mbi caktimin e rolit të Agjentit të Transferimit (*Shipping Agent*) për bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike Shqipëri–Kosovë”,

konstatoi se:

- ALPEX sh.a., nëpërmjet shkresës nr. 400 prot., datë 10.11.2023, të protokolluar në ERE me nr. 2408 prot., datë 15.11.2023, ka depozituar kërkesën me lëndë: “Mbi caktimin e rolit të Agjentit të Transferimit (*Shipping Agent*) për bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike të Shqipërisë dhe Kosovës”.

- ERE, me qëllim realizimin e procesit të konsultimit publik të kërkesës së parashtruar nga ALPEX sh.a., për caktimin e rolit të agjentit të



transferimit (*Shipping Agent*) për bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike Shqipëri–Kosovë, ka realizuar publikimin në faqen zyrtare të internetit të ERE-s në rubrikën konsultime në datën 17.11.2023.

- Në këtë proces konsultimi OST sh.a. nëpërmjet shkresës nr. 6116 prot., datë 30.11.2023, protokolluar në ERE me nr. 2408/1 prot., datë 4.12.2023, me lëndë: “Në lidhje me kërkesën e ALPEX për caktimin e rolit të Agjentit të Transferimit (*Shipping Agent*) për bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike Shqipëri–Kosovë”, shprehet se: “Nisur dhe nga eksperiencia e vendeve evropiane, sikurse e ka përmendur ALPEX sh.a. në shkresën e saj, kjo kërkesë ka mbështetjen e plotë të OST sh.a., e cila shprehet dakord me marrjen e këtij roli nga ana e ALPEX sh.a., për bashkimin e tregjeve të energjisë Shqipëri–Kosovë”.

- ERE, Rregullatori i Kosovës (ZRRE), si dhe operatorët respektivë të rrjetit të transmetimit OST sh.a. dhe KOSTT, në datën 21.10.2021, kanë nënshkruar marrëveshjen kornizë “Mbi bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike të Shqipërisë dhe të Kosovës”.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 347, datë 27.12.2022, vendosi miratimin e Rregullave të Tregut të Energjisë elektrike (rregullat e ALPEX-it, përkufizimet, procedura e tregtimit, si dhe procedura e klerimit dhe të shlyerjes). Këto rregulla janë miratuar njëkohësisht dhe nga Rregullatori i Kosovës (ZRRE), pasi shërbejnë për operimin e ALPEX-it në të dyja vendet.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 228, datë 17.7.2023, vendosi përcaktimin e ALPEX sh.a., si operator i emëruar i tregut të energjisë elektrike në tregun e bashkuar të Shqipërisë dhe të Kosovës, nëpërmjet një vendimmarrjeje të përbashkët të të dy rregullatorëve të Shqipërisë (ERE) dhe Kosovës (ZRRE). Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX sh.a. është një shoqëri aksionare, në bashkëpronësi të operatorëve të sistemeve të transmetimit të Shqipërisë (OST sh.a.) dhe Kosovës (KOSTT).

- Bordi i Rregullatorëve të Komunitetit të Energjisë (ECRB), në rekomandimin e mbledhjes së datës 24.4.2019, ndër të tjera, në pikën 1, germa “c”, rekomandon si vijon: Për sa i takon rolit të Agjentit Transferues, rregullorja CACM vlerëson: Zakonisht agjentë transferimi janë NEMO, por është, gjithashtu, e mundur që OST-të ta kryejnë këtë aktivitet në përputhje me nenin 8 (I) të Rregullores

CACM. Për më tepër, në përputhje me nenin 68 (6) të rregullores CACM, një agjent Transferimi mund të veprojë si kundër palë ndërmjet palëve të ndryshme qendrore për shkëmbimin e energjisë, nëse palët e interesuara lidhin një marrëveshje specifike për këtë qëllim. Për palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë rekomandohet, gjithashtu, t’i referohen një NEMO (d.m.th. operatori i tregut) për t’u përafruar me dispozitat e Rregullores CACM.

- Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 872, datë 27.12.2022, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 519, datë 13.7.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”, në pikën 2, germa “b” ka përcaktuar ndër të tjera, se: OST-ja të vendosë në dispozicion të tregut të organizuar një sasi minimum (50%) të kapaciteteve ndërkufitare të disponueshme, që i përket bashkimit respektiv të tregjeve.

- Në këtë kontekst, rregullorja e kërkesave dhe procedurave për përcaktimin e operatorit të emëruar të tregut të energjisë elektrike (NEMO), si dhe rolet e përgjegjësitë e NEMO-s dhe të operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë në tregun e bashkuar, miratuar me vendimin e ERE-s nr. 40/2020, përcakton se NEMO do të veprojë si palë qendrore për realizimin e shkëmbimit të energjisë, e cila rezulton nga bashkimi i tregut të ditës në avancë dhe atij brenda së njëjtës dite, si dhe do të realizojë procesin e shlyerjes për pjesëmarrësit e tregut në dy vendet tona. Në rastin konkret bashkimi i tregut ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës do të realizohet me dy *bidding* zona (zona ofertimi) dhe për të realizuar këtë bashkim do të alokohet një sasi minimale prej 50% e kapacitetit ndërkufitar të disponueshëm.

- Në rastet kur do të ketë konxhestion në këto zona ofertimi dhe do të ketë diferencë çmimi ndërmjet tyre të ardhurat e siguruara do të mbledhen nga NEMO dhe do t’u shpërndahen operatorëve të transmetimit proporcionalisht. Duke qenë se NEMO do të realizojë procesin e shlyerjes për pjesëmarrësit e tregut të bashkuar, do të realizojë dhe shlyerjen për operatorët e transmetimit për të ardhurat e krijuara nga konxhestioni.

- Në të njëjtën kohë rregullorja e Komisionit European 2015/1222, e cila vendos udhëzimet përkatëse për Alokimin e Kapaciteteve dhe Menaxhimin e Konxhestioneve (CACM) në nenin 68, pika 8, përcakton se: Të gjitha palët qendrore ose



agjentët transferues do të sigurojnë që të gjitha të ardhurat të cilat mblihen nga konxheshionet do t'i transferohen OST-ve jo më vonë se dy javë, pas datës së shlyerjes.

- Në këto kushte edhe ALPEX sh.a., e cila vepron si NEMO dhe si palë qendrore edhe në rastin konkret si agjent transferues duhet që të gjitha të ardhurat të cilat mblihen nga konxheshionet do t'i transfrohen OST-ve respektive (OST sh.a. dhe KOSTT) jo më vonë se dy javë pas datës së shlyerjes. Ky element është i nevojshëm edhe me qëllim për të garantuar neutralitetin financiar të Agjentit të Transferimit në procesin e mbledhjes dhe transferimit të të ardhurave që vijnë nga konxheshionet në interkoneksion. Gjithashtu, ERE do të vijojë të koordinojë punën me ZRRE, pasi kjo e fundit të përfundojë procesin e shqyrtimit të kërkesës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Caktimin e NEMO (ALPEX sh.a.) në rolin e "Agjentit të Transferimit" (*Shipping Agent*), për bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike të Shqipërisë dhe Kosovës.

2. Agjenti i Transferimit, të ardhurat të cilat mblihen nga konxheshionet do t'i transferojë OST-ve respektive jo më vonë se dy javë pas datës së shlyerjes.

3. Efektet juridike të kësaj vendimmarrje, hynë në fuqi pas bërjes operationale të bashkimit të tregjeve të energjisë elektrike Shqipëri-Kosovë.

4. Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Inspektiveve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

VENDIM

Nr. 370, datë 26.12.2023

MBI MIRATIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË "KARAVASTA SOLAR" SHPK PËR MARRJEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR TRANSFERIMIN (NËPËRMJET VENDOSJES SË HIPOTEKËS) E ASETVE FIKSE TË SAJ

Në mbështetje të neneve 16, 20, germa "a", dhe 44 të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; neneve 4, germat "a" dhe "b" dhe 10 të "Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 119, datë 21.7.2016; nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; pikës 1.3 dhe pikës 1.6 të "Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike"; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.12.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2305/11 prot., datë 21.12.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes "Mbi miratimin e kërkesës së shoqërisë 'Karavasta Solar' sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së hipotekës) e aseteve të paluajtshme si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve",

konstatoi se:

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2305 prot., datë 17.10.2023, shoqëria "Karavasta Solar" sh.p.k. (si palë huamarrëse), e licencuar nga ERE në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, paraqiti kërkesën për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës siguruese dhe hipotekës) përkatësisht të aseteve të kësaj shoqërie në Projektin Solar të Karavastasë prej 140 mw, ndaj palës huadhënëse (e përbërë nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), Korporata Financiare Ndërkombëtare (IFC), Intesa SanPaolo Bank Albania sh.a. dhe Privredna Banka Zagreb (Dionicko Drustvo), ku shoqëria Intesa SanPaolo Bank Albania sh.a. vepron si Agjent i Mjeteve të ekzekutimit të detyrimeve *onshore*, në zbatim të Marrëveshjes për kushtet e përbashkëta (të datës 19.4.2023), marrëveshje për barrën siguruese (nr. 4777 rep, nr. 970 kol., datë 13.10.2023) dhe



marrëveshjes së Hipotekës (nr. 4779 rep., nr. 972 kol., datë 13.10.2023).

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 312, datë 30.10.2023, vendosi të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Karavasta Solar” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës siguruese dhe hipotekës) të aseteve të paluajtshme të saj.

- ERE, me shkresën nr. 2305/3 prot., datë 1.11.2023 iu drejtua shoqërisë “Karavasta Solar” sh.p.k., duke e njoftuar mbi fillimin e procedurës dhe duke i kërkuar të sqarojë/plotësojë më tej dokumentacionin e konstatuar të plotësuar pjesërisht të këtij aplikimi.

- Po ashtu, me shkresën nr. 2372 prot., datë 3.11.2023, ERE ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) mbi fillimin e kësaj procedure.

- Në përgjigje, me shkresën me nr. 2305/5 prot., datë 13.11.2023, shoqëria “Karavasta Solar” sh.p.k. ka depozituar në ERE dokumentacionin plotësues e po ashtu;

- Me anë të postës elektronike (*e-mail*) të datës 13.12.2023, të protokolluar me nr. 2305/9 prot., ERE njoftoi shoqërinë për zhvillimin e një seance dëgjimore në datën 19.12.2023, në lidhje me sqarimin/plotësimin e dokumentacionit të këtij aplikimi.

- Me kërkesë të shoqërisë, seanca u zhvillua në mjediset e ERE-s, në datën 14.12.2023, ora 14:00, në të cilën përfaqësuesit e shoqërisë sqaruan të gjithë dokumentacionin e aplikimit, duke dhënë dhe informacionin shtesë të konstatuar të munguar gjatë fillimit të procedurës nga ERE.

- Me shkresat kthim përgjigjeje dhe nga sqarimet e dhëna në seancë, shoqëria ka saktësuar aplikimin e saj, duke kërkuar autorizimin e ERE-s për transferimin (nëpërmjet vendosjes së hipotekës) vetëm për asetet fikse të saj, sipas kontratës e hipotekës me nr. 4779 rep., nr. 972 kol., datë 13.10.2023.

- Për sa i përket arsyes së marrjes së një kredie me vlerë më të madhe se kontrata e zhvillimit të projektit me MIE, shoqëria ka sqaruar se kjo ka ardhur nga rritja e kostove të përgjithshme referuar kohës nga nënshkrimi i Marrëveshjes së Zhvillimit të projektit më 31.7.2020, e kryesisht të rritjes së çmimeve të paneleve fotovoltaike.

- Për sa i përket njoftimit/marrjes së miratimit të MIE-s, rezulton se në kuadër të këtij aplikimi është depozituar në ERE Marrëveshja e drejtpërdrejtë (DA), e nënshkruar në datë 12.10.2023, mes MIE-s (në cilësinë e Autoritetit Kontraktor), VOLTALIA SA (Shoqëria), “Karavasta Solar” shpk (Zhvilluesi) dhe Privredna Banka Zagreb – Diončko Društvo (Agjenti i Mjeteve të Ekzekutimit të Detyrimeve), ku përcaktohet se *Autoriteti Kontraktor pranon dhe konfirmon se, pavarësisht nga çdo kufizim apo rregullore që ka të bëjë me transferimin e aksioneve, interesave të kapitalit neto, biznesit si një vazhdimësi, ose aktiveve të biznesit brenda shoqërisë ose zhvilluesit, sipas marrëveshjes së zhvillimit të projektit, nuk do të ketë asnjë pengesë për transferimin e pronësive mbi aksionet, interesat e kapitalit ose aktivet e biznesit brenda shoqërisë ose Zhvilluesit, as nuk do të aktivizohet ndonjë ndryshim i kufizimeve të kontrollit për shkak të ndonjë veprimi detyrues nga ndonjë palë financuese sipas marrëveshjes së kushteve të përbashkëta ose ndonjë dokumenti financiar të lidhur.*

- Për sa më sipër konstatohet se kjo marrëveshje përbën njoftimin përkatës të autoritetit kontraktor, i cili është dhe palë nënshkruese e marrëveshjes direkte (PDA-së).

- Nga analiza përfundimtare e aplikimit, rezulton se shoqëria “Karavasta Solar” sh.p.k. ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar nga neni 7, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h”, “i” dhe “j”; pikat 3, 4 dhe 6 të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.7.2016.

- Dhënia e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së hipotekës) e aseteve fikse të shoqërisë “Karavasta Solar” sh.p.k. nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve/institucioneve të tjera apo palëve të treta për këtë transferim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe/institucione.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë “Karavasta Solar” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së hipotekës) të aseteve të paluajtshme të saj (sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi), si mjet për garantimin e detyrimit ndaj palës huadhënëse (e përbërë nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim



(BERZH), Korporata Financiare Ndërkombëtare (IFC), Intesa San Paolo Bank Albania sh.a. dhe Privredna Banka Zagreb (Dionicko Drustvo), ku shoqëria Intesa San Paolo Bank Albania sh.a. vepron si Agjent i Mjeteve të ekzekutimit të detyrimeve *onshore*.

2. Dhënia e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së hipotekës) e aseteve fikse të shoqërisë “Karavasta Solar” sh.p.k. nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve/institucioneve të tjera apo palëve të treta për këtë transferim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe/institucione.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Karavasta Solar” sh.p.k., dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

LISTA E PASURIVE TË PALUAJTSHME TË SHOQËRISË “KARAVASTA SOLAR” SHPK, NË PROJEKTIN SOLAR TË KARAVASTASË PREJ 140 mw

1. Ndërtesë kontrolli, me vlerë 188,420 EURO (njëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e katërqind e njëzet euro).

2. Nënstacion, me vlerë totale 2,715,740 EURO (dy milion e shtatëqind e pesëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e dyzet euro), pa përfshirë dy transformatorët kryesorë me specifikimet e mëposhtme:

a) linjë ohi me vlerë 161,684 EURO (njëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e katër euro);

b) shtyllë bus me kapës shtyllë me vlerë 195,861 EURO (njëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e një euro);

c) linjë transformatori pa transformatorët me vlerë 319,790 EURO (treqind e nëntëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë euro);

d) ndërtesa e kontrollit me specifikime 1,324,951 EURO (një milion e treqind e njëzet e katër mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e një euro) përfshirë:

- 2 clad metalike 36kv sf6 motorcentrali të insuluar 25ka/3s (brand: siemens, nr. Serial: 544682000010, seria nxplus ess) me vlerë 652,120 EURO (gjashtëqind e pesëdhjetë e dy mijë e njëqind e njëzet euro);

- bankë capacitor 2x5 mvar (2 copë) (brand: fuçi enerlux, nr. Sserial 222345, seria mfpi. 10.3/552/00) me vlerë 199,920 EURO (njëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e njëzet euro)

- dhe konektorët dhe lidhjet e mv pv-fider të prurjeve, transformatorë ndihmës, panele shërbimi ndihmëse, gjenerator diesel, ups, sistem ventilatorit, aksesore të tjerë (kablo, insulatorë, telekom, scada, sistem dedektimi të zjarrit etj.);

e) Aksesore të tjerë, sistem dedektimi zjarri dhe sistem matje, me vlerë 713,454 EURO (shtatëqind e trembëdhjetë mijë e katërqind e pesëdhjetë e katër euro).

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 371, datë 26.12.2023

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “SWISS BALANCING POOL” SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “e”, 5, pika 1, germa “e” dhe 13 “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.12.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr.



2302/14 prot., datë 19.12.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Swiss Balancing Pool’ sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Swiss Balancing Pool” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2302 prot., datë 17.10.2023, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 311, datë 30.10.2023, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në medien e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 1.11.2023 dhe 2.11.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 9.11.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën me nr. 2302/5 prot., datë 1.11.2023, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar vendimin e fillimit të procedurës dhe duke i kërkuar plotësimin e dokumentacionit të konstatuar të pa plotësuar/plotësuar pjesërisht, shkresë e cila u kthye mbrapsht nga shërbimi postar, me shënimin “I panjohur” ndaj në vijim shoqëria u njoftua nëpërmjet adresës së e-mail-it të lënë në kuadër të aplikimit.

- Shoqëria “Swiss Balancing Pool” sh.p.k. me shkresat nr. 2302/7 prot., datë 23.11.2023 dhe nr. 2302/8 prot., datë 24.11.2023, ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit të saj duke bërë me dije se nuk ka marrë njoftim zyrtar, por është njohur me vendimin nr. 311/2023 nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të ERE-s.

- Për shkak të kohës së pamjaftueshme për të shqyrtuar dokumentacionin e depozituar dhe nevojës për të vazhduar korrespondencën me shoqërinë, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 358, datë 1.12.2023 vendosi të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimarrjes përfundimtare mbi licencimin e shoqërisë “Swiss Balancing Pool” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Me shkresën me nr. 2302/10 prot., datë 6.12.2023, ERE ka njoftuar shoqërinë mbi vendimarrjen e Bordit për zgjatjen e afatit, dhe i ka sjellë në konsideratë se për të zhvilluar korre-

spondencën në rrugë shkresore me ERE-n shoqëria duhet të bëjë me dije një adresë të vlefshme.

- Në vijim subjekti me shkresën me nr. 2302/11 prot., datë 12.12.2023 ka konfirmuar adresat përmes të cilave do të zhvillohen korrespondencat në rrugë shkresore dhe elektronike.

- Me shkresën me nr. 2302/12 prot., datë 13.12.2023, ERE njoftoi shoqërinë se në kuadër të plotësimit të një dosjeje të plotë, subjekti duhet të depozitojë vërtetimin lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve, se ka shlyer të gjitha detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, dokumentacion i cili është përcjellë në ERE me shkresën e fundit me nr. 2302/13 prot., datë 14.12.2023, nga shoqëria.

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit në zbatim të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria “Swiss Balancing Pool” sh.p.k., ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar konform rregullores.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Swiss Balancing Pool” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar (pesëvjeçar).

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrje së vendimit, rishikimin e vendimi të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



NJOFTIM

Nr. 811/1, datë 25.1.2024

MBI HYRJEN NË FUQI TË NJË
MARRËVESHJEJE NDËRKOMBËTARE

“Memorandumi i mirëkuptimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shtetit të Kuvajtit për bashkëpunimin në fushën e bujqësisë”, nënshkruar në Tiranë, më 24.3.2016, ka hyrë në fuqi më 11.1.2024.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
Gazmend Turdiu

KËRKESË

Nr. 107/3, datë 24.1.2024

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësim shpall kërkesën për një ndryshim të VKM-së nr. 712, datë 11.1.2022, për shpronësimin për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit “Rikonstruksion i rrugës ‘Ago Celi’ dhe i ‘Rrugës së Re’, si dhe ‘Rikonceptimi i palestrës së lagjes ‘15 Shtatori’, Tepelenë”.

Subjekti kërkuar i këtij projekti është Bashkia Tepelenë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, për pasurinë e llojit “ndërtesë” bazuar në vendimin nr. 138, datë 23.2.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik, për pasuritë e llojit “ndërtesë banimi ose jobanimi”, i ndryshuar.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar, dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në listë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Bashkinë Tepelenë, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 4,531,296 (katër milionë e pesëqind e tridhjetë e një mijë e dyqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMEVE
Kastriot Gurra

LISTA EMËRORE PARAPRAKE E PASURIVE, PRONË PRIVATE, QË PREKEN PËR NJË NDRYSHIM I VKM-së NR. 712, DATË 11.1.2022, PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, PËR PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTTI “RIKONSTRUKSION I RRUGËS ‘AGO CELI’ DHE I ‘RRUGËS SË RE’, SI DHE ‘RIKONCEPTIMI I PALESTRËS SË LAGJES ‘15 SHTATORI’, TEPELENË”

Nr.	PRONARI							VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM, SIPAS LLOJIT TË PASURISË				SHËNIME
	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadastrale	Nr. i pas.	Lloji i pasurisë	Sip. totale (m²)	Ndërtesë			VLERA TOTALE (lek)	
								Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lek/m²)	Vlera (lek)		
	Iljas	Çobo	Qorri	3574	16/445 ND	Ndërtes e	160	160	28320.6	4,531,296	4,531,296	Konfirmuar nga ASHK-ja. Shtëpi banimi 2-katëshe. Kati përdhës 80 m² dhe kati i parë 80 m².
	Shuma paraprake										4,531,296	

**VENDIM***(i shkurtuar)*

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me vendimin nr. 5837, datë 9.11.2023, vendosi shpalljen e vdekjes më datë 15.5.1997 të shtetasit Xhavit Salia, i biri i Dalipit dhe i Hysnies, i lindur më datë 4.4.1951, në Tërbaç-Dibër dhe banues në Bashkinë Kamzë, Tiranë, si dhe caktimin e bashkëshortes së tij, shtetases Rukie Adem Salia, si kujdestare për administrimin e pasurisë të të ndjerit.

KËRKESË

Shtetasja Eda Miri kërkon pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë shpalljen e zhdukjes së shtetasit Valmir Hasan Miri, i biri i Hasan dhe Bukurije, i lindur më 6.12.1972, në Gramëz, Krujë dhe banues në Fushë-Krujë.

KËRKUESE**Eda Miri**

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë